

Erida Gjini (1983 –). Kërkuese shkencore në fushën e biomatematikës dhe epidemiologjisë teorike në nivel ndërkombëtar, drejtuese kërkimesh në Institutin Gulbenkian të Shkencës në Portugali (www.igc.gulbenkian.pt). Ka kryer shkollën tetëvjeçare ("Naim Frashëri", 1998) dhe pjesërisht të mesme (gjimnazi "Dhaskal Todri", 2000) në Elbasan. Në vitet 2000–2002 studioi në sistemin International Baccalaureate në Kolegjin e Botës së Bashkuar të Adriatikut në Duino, Itali (www.uwc.org). Mbaroi studimet e larta në Universitetin e Utrehtit (Utrecht University College) në Holandë (2005), me specializim cum laude në shkenca matematike. Gjatë 2005–2007 kreu studime pasuniversitare me bursën e ekselencës në masterin shkencor të matematikës së aplikuar në Universitetin e Utrehtit, në Fakultetin e Shkencave, departamentin e matematikës (www.uu.nl). Me mbarimin e masterit fitoi një bursë 4-vjeçare "Kelvin-Smith" për doktoraturë në Universitetin e Glasgout (www.gla.ac.uk), në Mbretërinë e Bashkuar, ku u specializua në biologjinë matematike dhe epidemiologjinë teorike të sëmundjeve infektive. Pasi mori titullin "Doktor shkencash" në 2012, filloi kërkimet shkencore postdoktorale në Portugali, në Institutin Gulbenkian të Shkencës, ku nga viti 2015 është kërkuese e pavarur dhe drejtuese e grupit të modelimit matematik të proceseve biologjike. Aktualisht, jeton dhe punon në Portugali. Erida Gjini ka një veprimtari të gjerë akademike dhe shkencore. Ka dhënë mësim universitare dhe pasuniversitare në fushën e matematikës së aplikuar, epidemiologjisë teorike, modelimit të sistemeve dinamike, dhe biologjisë komputacionale në biomjekësi, në Britani, Portugali dhe Cabo Verde.

Erida Gjini, me vetëm 5 vite nga marrja e titullit "Doktor shkencash", është autore e 14 artikujve shkencorë në revista ndërkombëtare prestigjioze, pjesëmarrëse në mbi 25 konferenca shkencore ndërkombëtare ndërdisiplinore dhe takime të specializuara.

Ka qenë e ftuar për referate shkencore në Universitetin e Lisbonës, në Universitetin e Glasgout, në Institutin e Mjekësisë Molekulare në Lisbonë, në Institutin e Kërkimeve për Zhvillim në Montpellier, dhe Universitetin e Tours në Francë.

Erida Gjini është promovuese e aplikimit të matematikës në shkencat biologjike, epidemiologjike dhe mjekësore. Studimet e saj në 2016 mbi rezistencën bakteriale ndaj antibiotikëve dhe optimizimit të terapive duke konsideruar rolin e imunitetit të bartësit tërthorë vëmendjen e mediave kombëtare në Portugali dhe më gjerë (www.publico.pt, www.rtp.pt), dhe u vlerësuan me nominimin për Kërkuesin e ri më të suksesshëm 2016 në shkencat natyrore dhe teknike nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë.

Aktualisht bashkëpunon me kërkues shkencorë në SHBA, Portugali, Francë dhe Mbretërinë e Bashkuar si në fushat e biologjisë së infeksioneve bakteriale, vaksinave dhe antibiotikëve, ashtu dhe në metodologjitë dhe principet matematikore për të analizuar proceset biologjike.

Deri tani ka udhëhequr disa tema masteri në Fakultetin e Shkencave në Universitetin e Lisbonës (www.fc.ul.pt), dhe është aktive në komisionet e doktoraturës për studentët e programit të Institutit Gulbenkian të Shkencës.

Erida Gjini dhe grupi që ajo drejton në Oeiras synojnë zhvillimin e modeleve të reja matematike të infeksioneve rezistente, kontrollit të sëmundjeve, dhe trajtimeve terapeutike të personalizuara.

Erida Gjini kryen rregullisht një seri aktivitesh duke përfshirë organizimin e takimeve dhe seminareve shkencore, konferencave ndërkombëtare të biomatematikës, koordinimin e moduleve të specializuara të programeve të masterit dhe doktoraturës në biologjinë e sistemeve dhe atë komputacionale, dhe revizion shkencor për revista prestigjioze dhe për fondacione shkencore ndërkombëtare. (Qershor, 2017)